

VENDIM
Nr. 160, datë 18.7.2025

**MBI PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “IDI 2005” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

(Ndryshuar me vendimin nr.211, datë 9.9.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1849/7 prot., datë 15.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1849 prot., datë 11.6.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 8.8 *mw*, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 124, datë 24.6.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.6.2025 dhe 26.6.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 4.7.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

Njoftimi dhe kërkesa për dokumentacionin plotësues

- Me shkresën nr. 1849/3 prot., datë 2.7.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, si dhe i ka kërkuar të bëjë me dije mbi nënshkrimin e Kontratës me shoqërinë, duke qenë se shoqëria ka depozituar vetëm miratimin paraprak. Nga ana e MIE-s nuk është depozituar kthim përgjigjeje.

- Me shkresën nr. 1849/4 prot., datë 2.7.2025, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të munguar.

Dorëzimi dhe vlerësimi i dokumentacionit plotësues

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1849/5 prot., datë 14.7.2025, ka depozituar në ERE një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, në vijim, me *e-mail*-in e po së njëjtës ditë, të protokolluar me nr. 1849/6 prot., ka kërkuar pezullimin e procedurës së licencimit, me 45 ditë, pasi nuk disponon ende kontratën e nënshkruar me MIE-n.

Pezullimi i afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 66, pika 1 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, kur shqyrtimi i një çështjeje administrative varet nga një çështje tjetër ligjore e pavarur (“çështje paraprake”), për të

cilën është kompetente një gjykatë ose organ tjetër, organi administrativ ka të drejtë të pezullojë procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë dhe njofton palët për pezullimin.

- Gjithashtu në nenin 14, pika 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë, rast pas rasti, pezullimin e vendimmarrjes pas fillimit të procedurës.

- Referuar kërkesës së shoqërisë dhe parashikimeve të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, për shkak dhe se kontrata e nënshkruar me MIE-n është dokument thelbësor për këtë procedurë, vlerësohet të pranohet kërkesa e shoqërisë dhe të pezullohet vendimmarrja e Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 8.8 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier. Shoqëria duhet të depozitojë kontratën e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 8.8 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, deri në një njoftim të dytë nga vetë shoqëria.

2. *Ky vendim është objekt rishikimi me depozitimin nga ana e shoqërisë të kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.*

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti